

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit D. D., Prizreni, për shkak të veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KP-ës sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.1857/13 të datës 04.09.2013, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Musli Gashi, të akuzuarit, me date 18.07.2016 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

D. D., nga i ati D., dhe e ëma S., e lindur S., i lindur me datën *data e lindjes...*, në Prizren, ku edhe jeton, në Rr... nr... , ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i shkurorëzuar, baba i tre fëmijëve, boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Prej datës së pavërtetuar e deri më dt. 25.07.2013, në Prizren, pikërisht në shtëpinë e tij, me qëllim të ndërhyrjes së paautorizuar në njehsorin elektrik me nr. 2567644, pasi që i njëjti ishte ç'kyçur nga rrjeti elektrik për shkak të borxhit, e dëmton shenjë zyrtare të ngjitur nga zyrtari i autorizuar i "KEDS", Distrikti në Prizren, përkatësisht pllombën distributive D200005150 dhe D200005301, të njehsorit elektrik dhe mundëson kycjen në rrjetin elektrik.

Këso dore ka kryer veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KP-ës.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 41, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75 dhe 76 të KPK-ës, te akuzuarit ia shqipton:

DENIM ME KUSHT

Ashtu qe i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër te re penale.

Obligohet i akuzuari qe ti paguaj shpenzimet në emër të paushallit gjyqësore shumen prej 20,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1857/13 të datës 04.09.2013, të akuzuarit D. D., nga Prizreni, për shkak të veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KP-ës.

Prokurori i shtetit Musli Gashi, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.1857/2013 të datës 04.09.2013, kundër të akuzuarit D. D., Prizreni, për shkak të veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave zyrtare nga neni 414 të KP-së, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu i akuzuari në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethana cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr parasysh pranimi i fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barë,

I akuzuari D. D., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranojë veprën penale cila më vihet në barë, këtë e them nga fakti që njehsori është në emrin tim, unë personalisht nuk i kam dëmtuar bllobat apo vulat zyrtare siç theksohet në aktakuzë, por duke pasur parasysh faktin që njehsori është në emrin tim, e pranojë fajësinë për veprën penale e cila më vihet në barë, por i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë, sjelljen time korrekte, që jam person familjar, baba i tre fëmijëve, dhe kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin, si dhe premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, të gjitha këto rrethana gjykata ti ketë parasysh me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, e po ashtu edhe faktin që jam person i vetëm që kujdesem për ekzistencën e familjes sime, dhe ate të tre fëmijëve, pasi që jam shkurorëzuar me ish bashkëshorten time, dhe me punën time të punëtorit të ndërtimtarisë kujdesem për tërë familjen time katër anëtarshë.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Prej datës së pavërtetuar e deri më dt. 25.07.2013, në Prizren, i akuzuari pikërisht në shtëpinë e tij, me qëllim të ndërhyrjes së paautorizuar në njehsorin elektrik me nr. 2567644, pasi që i njëjti ishte ç'kyçur nga rrjeti elektrik për shkak të borxhit, e dëmton shenjë zyrtare të ngjitur nga zyrtari i autorizuar i "KEDS", Distrikti në Prizren, përkatësisht pllombën distributive D200005150 dhe D200005301, të njehsorit elektrik dhe mundëson kyçjen në rrjetin elektrik.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që

pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave zyrtare nga neni 414 të KP-ës, dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me kusht, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform neni 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, mosha e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e tij pas konfliktit, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, është person familjar, baba i katër fëmijëve, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Vendimin mbi udhëzimin e të dëmtuarës në kontest të rregullt civil gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPP

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1343/13 me datë 18.07.2016

Procesmbajtësja
Naxhis Sharani

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.